

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Stuhia në Elbasan/ Përmytetet qyteti, dhjetëra banesa e makina nën ujë
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/13/stuhia-ne-elbasan-permytetet-qyteti-dhjetera-banesa-e-maki-na-nen-ujë/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 07:02:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 07:01:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f103c6c8893972cef5786ab91c5cf1144d387da311428f9773b57525c98e410e
TEKSTI	a978058f3e598c1f66f3480eb44e0070777c9df03f3cfe00783ec7030fed2d1d
PAMJA	feffc753d5d14ed5164d28aa46c95d68d257945a171b810f856d9199838f877f4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7d7d65ebbd825d1f13217f8ba70ecdc67e24c0eaa189feca0c833d78ff2cd4c6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a57398cf8eb56e5c3824c7ad1d9738b2b29a5a5940aff90c94875084de23f115
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/7d7d65ebbd825d1f13217f8ba70ecdc67e24c0eaa189feca0c833d78ff2cd4c6

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Stuhia në Elbasan/ Përmbytet qyteti, dhjetëra banesa e makina nën ujë

09:01 : 13/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE



Elbasani dje u përball me një stuhi të jashtëzakonshme .60 mm shi në vetëm 30 minuta, rreth 30 banesa e 20 bodrume të përmbytura, dhjetra automjete të dëmtuara dhe pemë të rrëzuara.

Një stuhi me reshje me intensitet të jashtëzakonshëm goditi gjatë mesditës së të shtunës qytetin e Elbasanit dhe zona të ndryshme të territorit të bashkisë, duke shkaktuar problematika të menjëhershme në infrastrukturë, banesa, biznese dhe qarkullimin rrugor.

Sipas të dhënave zyrtare të bëra publike nga Bashkia Elbasan, brenda vetëm 30 minutave janë regjistruar rreth 60 milimetra reshje shiu, një sasi e konsiderueshme që solli grumbullime të mëdha uji dhe përmbytje në disa pika të qytetit.

Menjëherë pas shfaqjes së problematikave, ekipet e emergjencave dhe shërbimeve publike dolën në terren për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve dhe për të menaxhuar pasojat e stuhisë. Fatmirësisht, nuk është raportuar asnjë person i lënduar.

Nga verifikimet paraprake të strukturave të Bashkisë, uji ka prekur rreth 30 banesa dhe 20 bodrume, në të cilat është ndërhyrë me pompa për largimin e ujit dhe rikthimin gradual të ambienteve në gjendje normale.

Lexo edhe:

[Rrebesht shiu e stuhi në Elbasan, përmbytet rrugët](#)[92 familje pa ujë të pijshëm në Fushë Bual, banorët: Punimet e hidrocentralit devijuan burimet](#)

Dëmet më të konsiderueshme janë evidentuar te automjetet e parkuara në parkimet nëntokësore, të cilat janë përballur me depërtimin e ujërave të reshjeve.

Stuhia ka shkaktuar gjithashtu rrëzimin e 10 pemëve, të cilat janë larguar nga rrugët nga ekipet e shërbimeve publike, duke mundur hapjen e akseve dhe normalizimin e qarkullimit.

Problematika nuk janë kufizuar vetëm në qytetin e Elbasanit. Prurjet e krijuara nga reshjet kanë shkaktuar dëmtime dhe vështirësi në disa rrugë të fshatrave dhe njësisve administrative.

Mietet dhe ekipet e shërbimeve publike kanë ndërhyrë në terren për pastrimin e rrugëve nga

TË GJITHA



Stuhia në Elbasan/ Përmbytet qyteti, dhjetëra banesa e makina nën ujë

09:01 : 13/09/2026



Media amerikane jehonë protestës kundër Ramës, publikon pamje nga tubimi

08:44 : 13/09/2026



Këmbimi valutor, 13 shtator 2026

08:27 : 13/09/2026



Pse i kemi çmimet kaq të shtrenjta ?! TVSH e ushqimeve, ndër më të lartat në Europë

08:09 : 13/09/2026



Parashikimi i motit për ditën e sotme

08:00 : 13/09/2026



Horoskopi, 13 shtator/ Zbulohet çfarë parashikojnë yjet për secilën shenjë

22:59 : 12/09/2026



"Arrestoni Ramën", protestuesit vazhdojnë rrëhimin e Kryeministrit

22:55 : 12/09/2026

materialet e sjella nga prurjet, duke bërë të mundur rikthimin e qarkullimit në segmentet e prekura.

Bashkia Elbasan ka bërë të ditur se të gjitha ndërmarrjet publike vijojnë të jenë në gatishmëri të plotë, me ekipe të angazhuara në terren për monitorimin e situatës dhe ndërhyrjen në çdo pikë ku paraqitet nevoja.

Edhe gjatë ditës së diel, strukturat e Bashkisë Elbasan vijojnë punën në terren për pastrimin, sistemin dhe rikthimin në gjendje normale të zonave të prekura.

Sipas Bashkisë, ndërhyrjet do të vijojnë pa ndërprerje në qytet dhe në njësitë administrative, deri në eliminimin e plotë të pasojave të shkaktuara nga reshjet.

Moti i keq i së shtunës nuk preku vetëm qytetin e Elbasanit, por pothuajse të gjithë territorin e qarkut të Elbasanit.

Reshjet intensive dhe prurjet e krijuara kanë shkaktuar problematika në segmente të ndryshme të rrugëve kombëtare dhe rurale, duke vështirësuar përkohësisht qarkullimin e automjeteve.

Në disa zona janë raportuar gjithashtu përmbajtje të tokave bujqësore, ndërsa strukturat lokale dhe shërbimet e emergjencave kanë vijuar monitorimin e situatës.

Pavarësisht intensitetit të jashtëzakonshëm të reshjeve, bilanci paraparak në Elbasan nuk regjistron persona të lënduar, ndërsa puna e strukturave publike vijon për të evidentuar dëmet dhe për të rikthyer normalitetin në të gjitha zonat e prekura. /BW

Etiketa: [elbasan](#) [moti i keq](#)

Lajme të lidhura



Rrebesh shiu e stuhi në Elbasan, përmbjten rrugët

15:29 : 12/09/2026



92 familje pa ujë të pijshëm në Fushë Bua, banorët: Punimet e hidrocentralit devijuan burimet

16:54 : 10/09/2026



Dhuhet në qendër të qytetit drejtori i Ujësjesit të Elbasanit, Luan Tabaku

09:51 : 10/09/2026



Banorët e Letanit në Elbasan protestojnë kundër ndotjes nga guroret: Na ka mbuluar pluhuri

10:35 : 09/09/2026



Transportonin emigrantë të paligjshëm, arrestohen dy të rinj në Elbasan

16:39 : 07/09/2026



Zjarr pranë banesave në Krastë të Elbasanit, rrezikohen dy shtëpi

19:51 : 06/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

[f](#) [ig](#) [yt](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.